

ROCINANTE

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

ROCINANTE është akaricid specifik për kontrollin e këpushave, i formuluar nga dy lëndë aktive me mënyrë veprimi të ndryshme, duke shkaktuar vdekjen e këpushave të trajtuara. Është aktiv kundër të gjitha fazave biologjike (vezëve, larvave, nimfave dhe të rriturve) duke vepruar nëpërmjet aparatit tretës si dhe kontaktit, me efekt të mirë translaminar dhe qëndrueshmëri të lartë.

GRUPI 10A/6 INSEKTICID

Lënda vepruese: *Hexythiazox 50 g/lit+abamectin 18 g/lit*

Formulimi: *Koncentrat i suspendueshem (SC)*

Masat parambrojtëse:

P405+P102: Ruajeni të mbyllur. Mbajeni larg fëmijëve.

P260: Mos thithni produktin.

P270: Mos hani, mos pini lëngje ose duhan kur përdorni këtë produkt.

P280: Vishni doreza dhe veshje mbrojtëse.

EUH401: Për të shmangur reziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet e përdorimit.

P501: Mblidhni ambalazhet në kontenierë të veçantë dhe bëni asgjësimin e tyre sipas rregullave në fuqi.

Udhëzim për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

H332: I dëmshëm nëse thithet.

H335: Mund të shkaktojë acarim të organeve të frymëmarrjes. Në rast kontakti me rrugët e frymëmarrjes: nëse nuhatet dilni menjëherë në ajër të pastër. Konsultohuni me mjekun.

H373: Mund të shkaktojë dëme në sistemin nervor pas ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur.

Në rast kontakti me lëkurën: Lahuni me shumë sapun dhe ujë, përfshirë flokët dhe thonjtë.

H319: Shkakton acarim serioz në sy.

P305+P351+P338: Nëse futet në sy: Shpëlani me ujë disa minuta. Nëse keni lente kontakti, hiqni ato nëse është elehtë. Vazhdoni shpëlarjen.

H302: I dëmshëm nëse gëlltitet.

P301+P312: Nëse gëlltitet: Telefononi menjëherë një mjek ose Qendrën kundër helmimit.

Këshillë e përgjithshme: Asnjëherë mos i jepni lëngje ose ti nxisni të vjella pacientit kur është pa vetëdije ose ka konvulsione.

Simptomat dhe efektet më të rëndësishme: Ekspozimi i zgjatur dhe/ose i përsëritur mund të dëmtojë sistemin nervor. Gëlltitja mund të shkaktojë përgjumje dhe marramendje.

Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Perdorimi:

Në agrume, kundër këpushave tetranikide (*Tetranychus urticae*, *Panonychus citri*, *Eutetranychus orientalis*).

Përdorni një spërkatës atomizues të montuar në traktor, me 1000-2000 lit ujë/ha, duke aplikuar ujë të mjaftueshëm për të mbuluar të gjithë sipërfaqen e bimës. Perdoret me 20-37.5 ml/hl, në fillim të infektimit, duke vazhduar me një normë maksimale prej 0.75 lit/ha.

Mos aplikoni më shumë se një herë/sezon. Përdorni normat më të larta kur prania e këpushave është e lartë.

Verejtje per perdorimin:

Për të shmangur problemet me rezistencën, alternoni me akaricide të tjera me mënyra të ndryshme veprimi. Mos aplikoni me akaricide të tjera që përmbajnë *abamectin* ose *hexythiazox*, më shumë se një herë në sezon. Nuk rekomandohet përzjerja me preparate të tjera. Lejohet vetëm për përdorime që lejojnë shkëmbimin e kontrolluar të materialit dhe energjisë me mjedisin përreth dhe parandalojnë lëshimin e produktit në mjedis, veçanërisht përdorimet në serra të përhershme.

Duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për:

- mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, si përdorimi i dorezave;
- efektin e fotolizës në nivelet e mbetjeve të pesticideve në kultura.

Vëmendje e veçantë kërkohet për të siguruar që provat e disponueshme të mbetjeve në të korrat, pasqyrojnë situatën më kritike të mbetjeve. Kur është e përshtatshme, në varësi të zonës, të zbatohen kufizime sezonale për kohën e aplikimit.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi në mjedis:

Spe8: E rrezikshme për bletët. Për të mbrojtur bletët dhe insektet e tjera pjalmuese mos e aplikoni tek bimët gjatë lulëzimit. Mos e përdorni aty ku bletët ushqehen në mënyrë aktive. Hiqni ose mbuloni bletët gjatë aplikimit dhe 2 ditë pas trajtimit. Mos e aplikoni tek barërat e këqija gjatë lulëzimit. Hiqni barërat e këqija para se të lulëzojnë. SP1: Mos e ndotni ujin me produktin ose ambalazhin e tij (mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor/shmangni ndotjen përmes kanalizimeve nga kopshtet dhe rrugët). Spe3: Për të mbrojtur organizmat ujor respektoni një zonë të ndërmjetme 20 m të pa spërkatur për masivet ujorë sipërfaqësorë. Spe3: Për të mbrojtur insektet e tjera respektoni një zonë të ndërmjetme të pa spërkatur prej 30 m në tokë jo bujqësore.

Karenca:

Trajtimi fundit para vjeljes: Agrumet 14 ditë.

Magazinimi:

Ruhet në vende të freskëta dhe në ambalazh origjinal, larg rrezeve direkte të diellit, në temperaturë deri 40° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 739/2, datë 16.4.2024

Sasia neto e PMB-së që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 lit.

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenjat e tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e kerkuesit: Proplan-Plant Protection Company. **Adresa:** C/Valle del Roncale, 12 28232-Las Rozas, Madrid, Spanje.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-së: Proplan-Plant Protection Company. **Adresa:** C/Valle del Roncale, 12 28232-Las Rozas, Madrid, Spanje.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet në Republikën e Shqipërisë):